



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije/Ministry of Economy



UDHËRRËFYESI PËR TRANZICION TË DREJTË

Just Transition Roadmap

Qershor, 2026

PËRMBAJTJA

Shkurtesat	4
1. Përmbledhje ekzekutive	6
2. Hyrje.....	7
2.1 Konteksti i tranzicionit të drejtë në Kosovë.....	7
2.2 Çfarë nënkupton tranzicioni i drejtë.....	8
2.3 Qëllimi i udhërrëfyesit.....	8
2.4 Parimet udhëheqëse të tranzicionit të drejtë	9
Gjithëpërfshirja dhe moslënia e askujt pas	9
Siguria e furnizimit	9
Dialogu social dhe pjesëmarrja.....	9
Zhvillimi i qëndrueshëm.....	9
Barazia dhe përfshirja sociale	9
Koordinimi institucional	9
Partneriteti dhe bashkëpunimi ndërkombëtar	9
3. Korniza strategjike dhe ligjore.....	9
3.1 Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2022–2031	10
3.2 Agjenda e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor (AGjBP)	10
3.3 Traktati i Komunitetit të Energjisë (TKE)	10
3.4 Ligjet kryesore të sektorit.....	11
4. Analiza e gjendjes aktuale	11
4.1 Struktura e sektorit të energjisë.....	11
4.2 Potenciali i investimeve në energjinë e ripërtëritshme	14
4.3 Eficienca e Energjisë (EE) në Kosovë	15
5. Vizioni strategjik, objektivat dhe rruga drejt tranzicionit të drejtë	15
Vizioni.....	16
5.1 Objektivat strategjike	17
5.1.1 Dekarbonizimi i sektorit të energjisë	17
5.1.2 Tranzicioni i drejtë për punëtorët dhe komunitetet	19
5.1.3 Korniza qeverisëse dhe institucionale	20
6. Korniza financiare dhe prioritetet për investime.....	22
6.1 Parimet e financimit.....	22
6.2 Burimet dhe struktura indikative e financimit.....	22

7. Plani i zbatimit, korniza monitoruese dhe indikatorët kyç të performancës.....	24
7.1 Fazat e zbatimit.....	24
7.1.1 Faza afatshkurtër për periudhën 2026–2028.....	24
7.1.2 Faza afatmesme për periudhën 2029–2032	25
7.1.3 Faza afatgjatë 2033 e tutje	25
7.2 Indikatorët e performancës	26
7.3 Menaxhimi i rrezikut	27
7.4 Masat kryesore të zbatimit.....	28
7.5 Përmirësimi i vazhdueshëm i politikave dhe i zbatimit	29
Referencat	30

Shkurtesat

Tabela e mëposhtme përmbledh shkurtesat dhe akronimet e përdorura në këtë dokument.

Shkurtesa	Përshkrimi i plotë
BE	Bashkimi Evropian
BEI	Banka Evropiane e Investimeve
BERZh	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BESS	Sistemet e Ruajtjes së Energjisë në Bateri (Battery Energy Storage Systems)
BRE	Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë
CO ₂	Dioksidi i karbonit
EE	Eficienca e Energjisë
FGD	Desulfurizimi i gazrave të tymit (Flue Gas Desulphurization)
FKEE	Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë
GIZ	Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
GET	Ekipi Ekonomik Gjerman (German Economic Team)
HC	Hidrocentralet
IFN	Institucionet financiare ndërkombëtare
IED	Direktiva për Emetimet Industriale
IPA	Instrumenti i Asistencës së Para-Anëtarësimit
KE	Komisioni Evropian
KEK	Korporata Energetike e Kosovës Sh.A.
KfW	Banka Gjermane për Zhvillim
KOSTT	Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut
ktoe	Mijë ton ekuivalent naftë
LPG	Gazi i lëngëzuar i naftës
ME	Ministria e Ekonomisë
MF	Ministria e Financave
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MPFVLÇ	Ministria e Punës, Familjes dhe Vlerave të Luftës Çlirimtare
MRVA	Monitorimi, Raportimi, Verifikimi dhe Akreditimi

Shkurtesa	Përshkrimi i plotë
NECP	Plani Kombëtar për Energji dhe Klimë
NERP	Plani Kombëtar për Reduktimin e Emetimeve
NOx	Oksidet e azotit
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
QRK	Qeveria e Republikës së Kosovës
SCADA/EMS	Sistemi i Mbikëqyrjes dhe i Menaxhimit të Energjisë
SO ₂	Dioksidi i squfurit
TC	Termocentral
WBIF	Korniza Investuese për Ballkanin Perëndimor (Western Balkans Investment Framework)
ZRrE	Zyra e Rregullatorit për Energji

1. Përmbledhje ekzekutive

Tranzicioni i drejtë në Republikën e Kosovës është një proces strategjik transformimi ekonomik, social dhe institucional, që synon të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm të vendit në kontekstin e dekarbonizimit gradual dhe të integritimit evropian. Ky proces nuk kufizohet vetëm në transformimin e sektorit të energjisë, ai përfshin një qasje më të gjerë ndaj zhvillimit ekonomik, mbrojtjes sociale, transformimit industrial, zhvillimit rajonal dhe përmirësimit të cilësisë së jetës së qytetarëve.

Në këtë drejtim, tranzicioni i drejtë paraqet një mundësi për të ndërtuar një model të ri zhvillimi ekonomik dhe social, që ndërthur modernizimin e sektorit energjetik me krijimin e mundësive të reja ekonomike, zhvillimin e aftësive të fuqisë punëtore, përfshirjen sociale dhe zhvillimin e qëndrueshëm rajonal.

Tranzicioni duhet të jetë gradual, i drejtë dhe gjithëpërfshirës, duke siguruar që askush të mos mbetet pas gjatë procesit të transformimit ekonomik dhe energjetik. Për këtë arsye, siguria e furnizimit me energji, mbrojtja e vendeve të punës dhe zhvillimi ekonomik lokal mbeten prioritetet thelbësore gjatë gjithë procesit.

Udhërrëfyesi për tranzicion të drejtë është hartuar në përputhje me Strategjinë e Energjisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2022–2031, si dhe Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor (AGjBP), procesin e integritimit evropian dhe prioritetet kombëtare për zhvillim ekonomik e social. Dokumenti synon të krijojë një kornizë të koordinuar për institucionet qendrore dhe lokale, sektorin privat, partnerët zhvillimorë dhe komunitetet lokale, në mënyrë që tranzicioni të zhvillohet në mënyrë të planifikuar.

Në aspektin energjetik, tranzicioni do të mbështetet në zhvillimin gradual të kapaciteteve të reja nga burimet e ripërtëritshme të energjisë modernizimin e kapaciteteve ekzistuese, avancimin e sistemeve të ruajtjes së energjisë, rritjen e eficiencës së energjisë, zgjerimin e sistemeve të ngrohjes qendrore dhe forcimin e integritimit rajonal të tregut të energjisë. Paralelisht, ai synon të krijojë mundësi të reja ekonomike përmes zhvillimit të sektorëve të lidhur me ekonominë e gjelbër, energjinë e pastër, eficiencën e energjisë dhe inovacionin.

Tranzicioni i drejtë synon gjithashtu të adresojë sfidat që lidhen me varfërinë energjetike, pabarazitë sociale dhe nevojën për përfshirje më të madhe të grupeve të cënueshme, grave dhe të rinjve në procesin e transformimit ekonomik dhe energjetik.

Tranzicioni i drejtë në Republikën e Kosovës do të zbatohet në tri (3) periudha kohore:

- periudha afatshkurtër (2026–2028);
- periudha afatmesme (2029–2032);
- periudha afatgjatë (2033 e tutje).

Në periudhën afatshkurtër, fokusi do të jetë krijimi i mekanizmave institucional, zhvillimi i politikave mbështetëse dhe fillimi i investimeve prioritare. Në periudhën afatmesme synohet përsheptimi i transformimit ekonomik dhe energjetik, zhvillimi i infrastrukturës mbështetëse dhe zbatimi i programeve sociale e ekonomike. Në periudhën afatgjatë synohet konsolidimi i një

modeli të ri ekonomik dhe energjetik, të bazuar në qëndrueshmëri, diversifikim ekonomik dhe integrim rajonal e evropian.

Ky udhërrëfytyes mbështetet në tri (3) shtylla strategjike:

Zhvillimi ekonomik – diversifikimi i aktiviteteve ekonomike dhe krijimi i mundësive të reja të punësimit;

Përgjegjësia mjedisore – reduktimi i emetimeve dhe përmirësimi i cilësisë së ajrit, tokës dhe ujërave;

Riaftësimi profesional dhe mbrojtja sociale – mbështetja e punëtorëve, familjeve dhe komuniteteve të prekura.

Përmes këtyre shtyllave, Republika e Kosovës synon të ndërtojë një tranzicion të drejtë dhe gjithëpërfshirës, që mbështet zhvillimin ekonomik afatgjatë, rrit qëndrueshmërinë sociale dhe kontribuon në transformimin gradual të vendit drejt një ekonomie moderne, konkurruese dhe të qëndrueshme.

2. Hyrje

2.1 Konteksti i tranzicionit të drejtë në Kosovë

Për dekada me radhë, sektori i energjisë në Republikën e Kosovës është mbështetur kryesisht në gjenerimin e energjisë elektrike nga termocentralet, ku edhe sot rreth nëntëdhjetë për qind (90%) e prodhimit vendor vazhdon të sigurohet nga termocentralet me bazë linjiti “Kosova A” dhe “Kosova B”.

Megjithatë, ky sektor përballet me sfida të shumta, të cilat lidhen me vjetërsinë e infrastrukturës ekzistuese, ndikimet mjedisore dhe shëndetësore, nevojën për reduktimin gradual të emetimeve të gazrave serrë, si dhe me kërkesat gjithnjë në rritje për përafrim me politikat dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian në fushën e energjisë dhe klimës.

Në këtë kontekst, Kosova ka nisur tranzicionin e saj energjetik përmes krijimit të një kuadri modern ligjor dhe rregullativ. Ky proces është shënuar me miratimin e Ligjit për Promovimin e Përdorimit të Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë si dhe me avancimin e reformave legjislative për transpozimin e Pakos së Energjisë së Pastër përmes Ligjit për Energjinë, Ligjit për Energjinë Elektrike dhe Ligjit për Rregullatorin e Energjisë. Këto reforma, së bashku me Strategjinë e Energjisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2022–2031, përbëjnë bazën për transformimin

gradual të sektorit të energjisë nga një model i mbështetur në linjit drejt një sistemi të bazuar në burime të ripërtëritshme, të qëndrueshme dhe konkurruese.

Përmes këtij udhërrëfytyesi synohet të sigurohet që tranzicioni energjetik dhe ridizajnimi i të gjithë zinxhirit të sektorit të energjisë të krijojë mundësi të reja për zhvillim ekonomik, investime, inovacion dhe punësim, duke garantuar që përfitimet e këtij transformimi të shpërndahen në mënyrë të drejtë dhe që askush të mos mbetet prapa.

2.2 Çfarë nënkupton tranzicioni i drejtë

Tranzicioni i drejtë është një qasje e integruar për menaxhimin e transformimeve ekonomike, energjetike dhe industriale, me qëllim që keto procese të realizohen në mënyrë të drejtë, gjithëpërfshirëse dhe të balancuar në aspektin social e ekonomik. Ky koncept bazohet në parimin se tranzicioni drejt një ekonomie më të qëndrueshme dhe me emetime më të ulëta të karbonit duhet të zhvillohet duke mbrojtur punëtorët, komunitetet dhe qytetarët që mund të preken nga këto ndryshime.

Objektivat e këtij udhërrëfytyesi janë hartuar në përputhje me konceptin e Komisionit Evropian (KE) për tranzicionin e drejtë, i cili përfshin dimensionet sociale, demografike, ekonomike, shëndetësore dhe mjedisore të kalimit drejt një ekonomie të qëndrueshme dhe të gjelbër. Në këtë kuadër, Rregullorja (BE) 2021/1056 për Fondin për Tranzicion të Drejtë përbën një nga instrumentet kryesore mbështetëse. Gjithashtu, udhërrëfytyesi mbështetet në Planin e Veprimt për zbatimin e Deklaratës së Sofjes për Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor për periudhën 2021–2030.

Në kontekstin e Kosovës, tranzicioni i drejtë është një proces afatgjatë dhe gradual, që duhet të balancojë nevojën për modernizimin dhe dekarbonizimin e ekonomisë me nevojën për ruajtjen e sigurisë energjetike, stabilitetit ekonomik dhe kohezionit social.

2.3 Qëllimi i udhërrëfytyesit

Qëllimi i këtij udhërrëfytyesi është të krijojë një kornizë strategjike dhe orientuese për planifikimin dhe zbatimin e tranzicionit të drejtë në Republikën e Kosovës. Në mënyrë më specifike, dokumenti synon të:

- identifikojë prioritetet strategjike për tranzicionin e drejtë;
- orientojë investimet dhe politikat publike drejt zhvillimit të qëndrueshëm;
- mbështesë transformimin gradual ekonomik, social dhe energjetik;
- promovojë zhvillimin ekonomik lokal dhe diversifikimin e ekonomisë.

Udhërrëfytyesi synon gjithashtu të krijojë një bazë të përbashkët për dialog ndërinstitucional dhe shoqëror mbi prioritetet strategjike dhe drejtimin afatgjatë të zhvillimit ekonomik dhe energjetik të vendit.

2.4 Parimet udhëheqëse të tranzicionit të drejtë

Procesi i tranzicionit të drejtë në Republikën e Kosovës udhëhiqet nga parimet që synojnë të sigurojnë një tranzicion të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës:

Gjithëpërfshirja

Tranzicioni duhet të sigurojë që punëtorët, komunitetet lokale, grupet e cënueshme dhe zonat e prekura të mbështeten në mënyrë aktive gjatë procesit të transformimit ekonomik dhe energjetik.

Siguria e furnizimit

Transformimi i sektorit energjetik duhet të realizohet gradualisht dhe në mënyrë të planifikuar, duke ruajtur sigurinë e furnizimit me energji dhe stabilitetin ekonomik të vendit.

Dialogu social dhe pjesëmarrja

Procesi i tranzicionit duhet të mbështetet në dialog të vazhdueshëm me punëtorët e ndikuar, komunitetet lokale, sektorin privat, shoqërinë civile dhe partnerët zhvillimorë.

Zhvillimi i qëndrueshëm

Politikat dhe investimet duhet të kontribuojnë në zhvillim ekonomik afatgjatë, mbrojtje të mjedisit dhe përmirësim të mirëqenies sociale.

Barazia dhe përfshirja sociale

Tranzicioni duhet të promovojë barazinë gjinore, përfshirjen e të rinjve dhe mbështetjen për grupet e marginalizuara e komunitetet e cënueshme.

Koordinimi institucional

Zbatimi efektiv i tranzicionit kërkon koordinim të ngushtë ndërinstitutional dhe bashkëpunim ndërmjet nivelit qendror dhe lokal.

Partneriteti dhe bashkëpunimi ndërkombëtar

Procesi i tranzicionit do të mbështetet përmes bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë, institucionet financiare ndërkombëtare dhe organizatat zhvillimore që mbështesin tranzicionin e gjelbër dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

3. Korniza strategjike dhe ligjore

Procesi i tranzicionit të drejtë në Republikën e Kosovës zhvillohet në përputhje me prioritetet kombëtare për zhvillim ekonomik e social, objektivat strategjike të sektorit energjetik dhe obligimet ndërkombëtare të vendit në fushën e energjisë dhe klimës. Në këtë kontekst, tranzicioni i drejtë mbështetet në një kornizë të gjerë strategjike dhe ligjore, e cila orienton transformimin gradual të ekonomisë dhe të sektorëve strategjikë drejt një modeli më të qëndrueshëm e konkurrues.

3.1 Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2022–2031

Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2022–2031 është dokumenti kryesor strategjik për zhvillimin e sektorit energjetik në Republikën e Kosovës dhe përcakton drejtimin afatmesëm të tranzicionit energjetik të vendit. Ajo mbështetet në pesë (5) objektiva kryesore:

- përmirësimi i besueshmërisë së sistemit;
- dekarbonizimi dhe promovimi i energjisë së ripërtëritshme;
- rritja e eficiencës së energjisë;
- forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe funksionimi i tregut;
- mbrojtja dhe fuqizimi i konsumatorëve dhe zhvillimi i fuqisë punëtore.

Në këtë drejtim, Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës për periudhën 2022–2031 parasheh zhvillimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga energjia diellore dhe e erës, avancimin e sistemeve të ruajtjes së energjisë, zgjerimin e sistemeve të ngrohjes qendrore dhe modernizimin e infrastrukturës energjetike. Ajo thekson gjithashtu rëndësinë e një tranzicioni të planifikuar dhe gradual, duke ruajtur sigurinë e furnizimit dhe duke adresuar ndikimet sociale e ekonomike të transformimit të sektorit.

3.2 Agjenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor (AGjBP)

Republika e Kosovës është pjesë e procesit rajonal të tranzicionit të gjelbër në kuadër të Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, e cila synon përafrimin gradual të rajonit me objektivat klimatike të Bashkimit Evropian (BE). Agjenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor përfshin pesë (5) shtylla kryesore:

- klima, energjia dhe mjedisi;
- ekonomia qarkore;
- reduktimi i ndotjes;
- bujqësia dhe prodhimi i qëndrueshëm i ushqimit;
- biodiversiteti.

Në këtë kontekst, tranzicioni i drejtë në Kosovë është një instrument i rëndësishëm për mbështetjen e zbatimit të Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, dhe për promovimin e zhvillimit ekonomik e social të qëndrueshëm.

3.3 Traktati i Komunitetit të Energjisë (TKE)

Si palë kontraktuese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë (TKE), Republika e Kosovës është e obliguar të harmonizojë legjislacionin e energjisë me *acquis*-në e Bashkimit Evropian (BE) dhe të zhvillojë një treg energjetik të integruar e funksional. Procesi i tranzicionit të drejtë lidhet ngushtë me këto zhvillime, pasi transformimi gradual i sektorit energjetik kërkon investime të konsiderueshme në infrastrukturë, fleksibilitet të sistemit dhe zhvillim të kapaciteteve institucionale.

3.4 Ligjislacioni

Procesi i tranzicionit të drejtë mbështetet nga një sërë ligjesh dhe politikash plotësuese që adresojnë dimensionet kryesore të tij, përfshirë:

- Ligji për Energjinë;
- Ligji për Energjinë Elektrike;
- Ligji për Rregullatorin e Energjisë;
- Ligji për Energjinë Termike;
- Ligji për Eficiencën e Energjisë;
- Ligji për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë;
- Ligji për Ndryshimet Klimatike.

Reformat legjislative në vijim do të krijojnë bazën ligjore për forcimin e qeverisjes së tranzicionit të drejtë në Kosovë. Në këtë kuadër, parashihet zhvillimi dhe vendosja e sistemit të Monitorimit, Raportimit, Verifikimit dhe Akreditimit (MRVA) si mekanizëm mbështetës për planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave të tranzicionit, duke siguruar të dhëna të besueshme për reduktimin e emetimeve dhe për instrumentet ekonomike të lidhura me dekarbonizimin e sektorit të energjisë.

Zhvillimi dhe integrimi i sistemit Monitorimit, Raportimit, Verifikimit dhe Akreditimit (MRVA) do të lidhet drejtpërdrejt me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ndryshimet Klimatike. Përmes këtyre ndryshimeve do të krijohet baza ligjore për përfshirjen e MRVA-së në legjislacionin primar.

4. Analiza e gjendjes aktuale

4.1 Struktura e sektorit të energjisë

Sektori i energjisë në Republikën e Kosovës është i organizuar në hallkat kryesore të prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit, të mbështetura nga një kornizë rregullatore dhe e tregut. Prodhimi vendor i energjisë elektrike mbetet i mbështetur kryesisht në linjit, me një kontribut plotësues nga hidrocentralet dhe nga kapacitetet e reja të burimeve të ripërtëritshme. Transmetimi i energjisë menaxhohet nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT), ndërsa shpërndarja dhe furnizimi me energji elektrike kryhen nga ndërmarrjet e licencuara për këto veprimtari. Funksonimi i tregut dhe mbikëqyrja rregullatore sigurohen nga autoriteti rregullator i energjisë, i cili licencon operatorët dhe rregullon qasjen në rrjet dhe tarifat. Brenda kësaj strukture, gjenerimi vendor dominohet nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), e cila ndërthur nxjerrjen e qymyrit me gjenerimin e energjisë elektrike.

Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) Sh.A. është ndërmarrja kryesore e prodhimit të energjisë në Republikën e Kosovës. Ajo është në pronësi të plotë të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Funkcioni parësor i Korporatës është nxjerrja e qymyrit dhe gjenerimi i energjisë elektrike. Për t'i

përmbushur këto dy funksione, KEK është i organizuar në katër (4) divizione: Divizionin e Mihjeve, Divizionin e TC Kosova A, Divizionin e TC Kosova B dhe Divizionin e Burimeve të Ripërtërishme i krijuar në vitin 2024. Korporata operon me mihjen sipërfaqësore të linjitit (Mihja e Sibovcit Jugperëndimor) dhe me dy termocentrale, TC “Kosova A” dhe TC “Kosova B”. Aktualisht ka rreth katër mijë (4.000) të punësuar në fusha të ndryshme të operimit, që e bën KEK-un një nga punëdhënësit më të mëdhenj në vend dhe boshtin ekonomik të komunave Obiliq dhe Fushë Kosovë.

Në strukturën aktuale të prodhimit, dy termocentralet me linjit mbulojnë rreth nëntëdhjetë për qind (90%) të prodhimit vendor të energjisë elektrike, ndërsa pjesa tjetër sigurohet nga hidrocentralet, nga kapacitetet ende të kufizuara të erës e diellit dhe nga importet. Kjo strukturë e përqendruar në linjit është njëkohësisht burimi kryesor i emetimeve të gazrave serrë dhe i ndotjes lokale të ajrit, pra pika nga ku nisët tranzicioni. Tabela 1 përmbledh treguesit bazë të sektorit, të cilët shërbejnë si pikë referimi për matjen e progresit në vitet në vijim.

Treguesi bazë	Vlera	Viti / burimi
Pjesëmarrja e linjitit në prodhimin vendor të energjisë elektrike	≈ 90%	2023-2024 - KEK / Komuniteti i Energjisë (KE)
Numri i të punësuarve në KEK	≈ 4.000	2026 - KEK
Kapaciteti diellor i instaluar	≈ 26.002 MW	2026 - ZRRE Raporti vjetor
Emetimet e NOx të termocentraleve ndaj tavanit të NERP-it	2,73 herë mbi tavan	2023 - Komuniteti i Energjisë (KE)
Konsumi në sektorin e ndërtesave ndaj konsumit total	> 40%	Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2022–2031
Caku i pjesëmarrjes së BRE-ve në konsumin e energjisë elektrike	≥ 35% deri në 2031	Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2022–2031

Tabela 1. Treguesit bazë të sektorit të energjisë (pika e nisjes për matjen e progresit)

Njësia prodhuese	Kapaciteti i instaluar (MW)	Kapaciteti neto (MW)
TC “Kosova A”	610	432
TC “Kosova B”	678	528

Njësia prodhuese	Kapaciteti i instaluar (MW)	Kapaciteti neto (MW)
Hidrocentrale (HC)	135,904	132,004
Centrale me erë	137,16	137,16
Centrale fotovoltaike (FV)	26,002	26,002
Biomasë	1,12	1,12
Prosumatorë	26,238	26,238
Total	1.614,424	1.282,524

Tabela 2. Kapacitetet e instaluara të prodhimit të energjisë elektrike

Të dyja termocentralet ndodhen në komunën e Obiliqit. TC “Kosova A” u ndërtua në periudhën 1962–1975 me pesë (5) njësi; dy (2) njësitë e para janë tashmë jashtë përdorimit, ndërsa mbeten në operim tri (3) njësi me kapacitet rreth 200 MW secila. TC “Kosova B” përbëhet nga dy (2) njësi prej 339 MW secila, të vëna në punë në vitet 1983–1984. Mosha e lartë e këtyre kapaciteteve, veçanërisht e njësive të “Kosova A”, përcakton në masë të madhe sekuencën e tranzicionit: njësitë më të vjetra i afrohen fundit të jetëgjatësisë teknike, ndërsa TC “Kosova B” i nënshtrohet modernizimit për të përmbushur standardet e Direktivës për Emetimet Industriale (IED) dhe për të shërbyer si kapacitet bazë gjatë fazës kalimtare.

Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT), ka një plan zhvillimor për periudhën 2025–2034 që përqendrohet në përforcimin e rrjetit. Plani përshkruan investime strategjike për përmirësimin e rrjetit të transmetimit, duke mundësuar rritjen e integritetit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe duke mbështetur indirekt një tranzicion të drejtë. Projektet kryesore përfshijnë ndërtimin dhe përmirësimin e linjave të transmetimit me tension të lartë, të cilat mbështesin kapacitetin e rrjetit për BRE-të, të ndryshueshme si era dhe dielli. Investimet në teknologjitë e rrjetit inteligjent – si përmirësimet SCADA/EMS dhe matja inteligjente – përmirësojnë menaxhimin e rrjetit dhe mundësojnë pjesëmarrjen e konsumatorëve, ndërsa Sistemet e Ruajtjes së Energjisë në Bateri (BESS) adresojnë ndërprerjen e BRE-ve dhe sigurojnë furnizim të besueshëm.

Këto përmirësime mund të lehtësojnë arritjen e objektivit për tridhjetë e pesë për qind (35%) pjesëmarrje të BRE-ve në konsumin e energjisë elektrike deri në vitin 2031 dhe të promovojnë një tranzicion të drejtë, duke krijuar vende pune të gjelbra në rajone si Obiliqi, historikisht të varura nga qymyri, dhe duke mbështetur diversifikimin ekonomik. KOSTT ka projekte të financuara edhe nga Bashkimi Evropian (BE) dhe nga institucionet financiare ndërkombëtare (IFN), si Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) dhe KfW.

Fokusi i planit në ndërlidhjet rajonale si integrimi me Bursën Shqiptare të Energjisë (ALPEX) mbështet tregtinë ndërkufitare të energjisë së ripërtëritshme, duke rritur sigurinë e energjisë dhe integrimin e BRE-ve në rrjet. Asetet fleksibile të rrjetit, si sistemet dinamike të vlerësimit të linjave, optimizojnë infrastrukturën për të akomoduar integrim më të lartë të BRE-ve. Për një tranzicion

të drejtë, këto investime zbusin në mënyrë indirekte ndikimet sociale dhe ekonomike, duke siguruar infrastrukturë për projekte të vogla të BRE-ve, duke fuqizuar komunitetet e energjisë dhe duke krijuar mundësi punësimi në sektorin e Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë (BRE).

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRë) është organ rregullator i pavarur. Funkzioni i saj kryesor është të rregullojë aktivitetet në sektorin e energjisë përkatesisht energjisë elektrike dhe ngrohjen qendrore në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë (TKE). Mandati i Zyres së Rregullatorit të Energjisë përfshin lëshimin e licencave dhe monitorimin e zbatimit të tyre, miratimin e tarifave për aktivitetet e shërbimeve publike, vendosjen e detyrimeve të furnizimit publik, ofrimin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe hartimin e legjislacionit dytësor. ZRRë është gjithashtu përgjegjëse për krijimin e kornizës rregullatore që siguron funksionim transparent dhe jodiskriminues të tregut të energjisë.

4.2 Potenciali i investimeve në energjinë e ripërtërishme

Kosova ka potencial të konsiderueshëm për investime në energjinë e ripërtërishme. Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2022–2031 synon një kapacitet të përgjithshëm kumulativ prej rreth 1.600 MW nga BRE deri në vitin 2031, prej të cilave rreth 1.320 MW janë kapacitete të reja. Kjo përfshin 600 MW nga era, 600 MW nga energjia diellore, 20 MW nga biomasa dhe të paktën 100 MW nga konsumatorët vetëprodhues (prosumatorë).

Me rrezatim të lartë diellor (rreth 1.500–1.600 kWh/m² në vit) dhe korridore të favorshme të erës, Kosova ofron mundësi tërheqëse, të mbështetura nga një mjedis konkurrues biznesi, norma të ulëta tatimore (10% tatim të fitimit të korporatave) dhe një kuadër transparent për investimet e huaja. Në tërësi, Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2022 – 2031 synon që deri në vitin 2031 të paktën tridhjetë e pesë për qind (35%) e konsumit të energjisë elektrike të mbulohet nga Burimet e Ripërtërishme (BR) dhe, paralelisht, reduktimin e emetimeve të Gazrave Serrë (GS) në sektorin e energjisë me të paktën tridhjetë e dy për qind (32%) krahasuar me nivelet e vitit 2020. Këto objektiva do të arrihen kryesisht përmes ankandëve dhe investimeve private.

Në vitin 2024, Kosova përfundoi ankandin e saj të parë për energji diellore, prej të cilit derivoi fituesi për realizimin e parkut solar prej 100 MW në Kramovik (Komuna e Rahovecit), me çmim prej 48,88 €/MWh. Ankandi siguroi një proces transparent dhe të barabartë për ofertuesit e kualifikuar dhe dëshmoi interesin në rritje të investitorëve për potencialin e gjerë të BRE-ve. Në fund të vitit 2024, Kosova nisi gjithashtu ankandin e parë për energjinë e erës, për mbështetjen e energjisë së prodhuar nga era me kapacitet të synuar prej 50 deri 100 MW. Aktualisht është e hapur faza e dytë e procesit (Kërkesa për Propozime).

KEK po avancojnë gjithashtu iniciativat e saj në fushën e burimeve të ripërtërishme. Projekti i parë i shkallës së madhe, parasheh një central fotovoltai (FV) me lidhje rrjeti me kapacitet minimum 100 MW në fushat e ish-deponive të hirit pranë TC “Kosova A”, me kosto totale rreth 104 milionë euro. Financimi është i strukturuar si kombinim grant-kredi: një grant prej rreth 32 milionë euro nga Korniza Investuese për Ballkanin Perëndimor (WBIF) e financuar nga BE-ja, një kredi prej 33 milionë euro nga Banka Evropiane e Investimeve (BEI) dhe një kredi prej 29 milionë euro nga

KfW. Centrali pritët të prodhojë rreth 150–170 GWh në vit dhe të shmangë mbi 150.000 ton CO₂ në vit, duke rritur kapacitetin diellor të vendit nga rreth 10 MW në mbi 110 MW. Për menaxhimin e këtij projekti dhe të projekteve të ardhshme është krijuar një Njësi e dedikuar për Zbatimin e Projektit, së bashku me një divizion të specializuar për burimet e ripërtëritshme që paraqet një ngritje kapacitësh institucionale të rëndësishme për tranzicionin e drejtë.

4.3 Eficienca e Energjisë në Kosovë

Eficienca e Energjisë është një nga instrumentet kryesore për uljen e konsumit dhe përmirësimin e performancës energjetike në nivel vendi. Deri tani, masat e eficiencës janë zbatuar në ndërtesa publike dhe rezidenciale, në përputhje me caqet e Strategjisë së Energjisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2022–2031. Paralelisht, familjet dhe Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM) janë mbështetur përmes programeve të dedikuara që synojnë rritjen e eficiencës dhe përdorimin e burimeve të ripërtëritshme. Me qëllim të uljes së konsumit, investimi në masa efieencie në ndërtesa publike dhe rezidenciale do të vazhdojë, përfshirë përmes mbështetjes së donatorëve dhe Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE).

5. Vizioni strategjik, objektivat dhe rruga drejt tranzicionit të drejtë

Duke u bazuar në kontekstin dhe prioritetet strategjike, ky kapitull përcakton vizionin afatgjatë, objektivat strategjike dhe drejtimet kryesore për zbatimin e tranzicionit të drejtë energjetik në Kosovë, duke shërbyer si bazë orientuese për transformimin e sektorit të energjisë.

Tranzicioni i drejtë energjetik në Republikën e Kosovës zhvillohet në një kontekst ku sektori i energjisë ka qenë historikisht i mbështetur në linjit, duke krijuar një varësi të lartë jo vetëm në aspektin e prodhimit të energjisë, por edhe në strukturën ekonomike e sociale të komunave ku vepron KEK. Korporata pritët të luajë një rol kyç në procesin e tranzicionit, përtej rolit si ndërmarrje publike, ajo është një entitet me aktivitet intensiv minerar që ka gjeneruar punësim për komunitetet lokale për dekada me radhë.

Në këtë kontekst, tranzicioni i drejtë nuk është vetëm një transformim teknik i sektorit të energjisë, por edhe një proces i gjerë social dhe territorial, që kërkon adresim të kujdesshëm të ndikimeve ekonomike e sociale. KEK SH.A. pritët të kontribuojë përmes rehabilitimit e modernizimit të njësive ekzistuese dhe diversifikimit të strukturës së prodhimit, duke mundësuar zhvillimin e kapaciteteve të reja gjeneruese dhe duke mbështetur kalimin gradual nga linjiti drejt burimeve të ripërtëritshme të energjisë, pa rrezikuar sigurinë e furnizimit gjatë fazës së tranzicionit.

Një nga shtyllat kryesore të Strategjisë së Energjisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2022–2031 është dekarbonizimi i sektorit. Ky proces bazohet në zhvillimin e kapaciteteve të reja nga burimet e ripërtëritshme të energjisë, në reduktimin gradual të kapaciteteve të njësive nga TC “Kosova A” deri në pikën kur mbeten si rezervë strategjike, si dhe në uljen graduale të përdorimit të energjisë elektrike për ngrohje përmes alternativave më të pastra. Në këtë kuadër, zhvillimi i sistemeve të ngrohjes qendrore në nivel komunal, të bazuara në burime të ripërtëritshme dhe

teknologji me emetime të ulëta, është instrument kyç për reduktimin e kërkesës për energji elektrike, uljen e ndotjes dhe forcimin e sigurisë së furnizimit, veçanërisht gjatë muajve të dimrit.

Procesi i tranzicionit kërkon bashkëpunim të ngushtë ndërinstitucional dhe koordinim me nivelin lokal, pasi projektet e BRE-ve dhe infrastruktura mbështetëse do të zhvillohen në komuna dhe do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve. Rëndësi do të i kushtohet edhe rritjes së aftësisë për të përmbushur kërkesat në rritje të tregut të punës, përmes zhvillimit të aftësive dhe përgatitjes së fuqisë punëtore për sektorët e rinj të lidhur me energjinë e pastër dhe ekonominë e gjelbër.

Vizioni

Vizioni i tranzicionit të drejtë në Republikën e Kosovës është ndërtimi i një sistemi energjetik të pastër, të sigurt dhe gjithëpërfshirës, që kontribuon në rritjen e qëndrueshme ekonomike, mbrojtjen e mjedisit dhe përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve. Ky tranzicion është jo vetëm një transformim strukturor i sektorit të energjisë, por edhe një angazhim i gjerë kombëtar për zhvillim të qëndrueshëm, barazi ndërmjet rajoneve dhe mbrojtje sociale.

Vizioni bazohet në nevojën për të zvogëluar gradualisht varësinë nga linjiti, për të diversifikuar burimet e energjisë dhe për të nxitur inovacionin në sektorët ekonomikë të lidhur me energjinë. Duke integruar dimensionin ekonomik, social dhe mjedisor, tranzicioni i drejtë synon të forcojë qëndrueshmërinë e vendit dhe të rrisë rolin e Kosovës në zhvillimet rajonale dhe evropiane në fushën e energjisë së qëndrueshme.

Vizioni mbështetet në tri (3) drejtime kryesore strategjike:

- **Zhvillimi ekonomik** dhe tranzicioni i drejtë krijon bazën për një model të ri zhvillimi, duke mundësuar diversifikimin e aktiviteteve ekonomike përtej sektorëve tradicionalë të lidhur me linjitin. Ky proces kontribuon në transformimin e sektorëve ekzistues, veçanërisht në fushën e BRE-ve, eficiencës së energjisë dhe shërbimeve të ekonomisë së gjelbër, duke gjeneruar mundësi të reja punësimi e investimi.
- **Përgjegjësia mjedisore** kjo qasje synon zvogëlimin e emetimeve të gazrave serrë përmirësimin e cilësisë së ajrit, tokës e ujërave dhe rehabilitimin e zonave natyrore e industriale të dëmtuara. Zhvillimi i sektorit do të bazohet në parimin që rritja ekonomike dhe mbrojtja e mjedisit ecin paralelisht.
- **Riaftësimi profesional dhe mbrojtja sociale** në tranzicionin e drejtë vendos qytetarin në qendër të procesit, duke garantuar mbrojtje sociale, siguri ekonomike dhe mundësi të barabarta. Përqendrimi kryesor janë punëtorët, familjet dhe komunitetet që preken nga ndryshimet në sektor.

Përmes bashkëpunimit ndërinstitucional, tranzicioni do të shoqërohet me masa mbështetëse sociale, politika aktive të punësimit dhe masa të posaçme për grupet e cënueshme. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet barazisë gjinore, grupeve të marginalizuara dhe përfshirjes së të rinjve, duke siguruar që tranzicioni të jetë gjithëpërfshirës dhe të mos krijojë pabarazi të reja sociale.

Së bashku, këto drejtime krijojnë një qasje të balancuar dhe të integruar, ku zhvillimi ekonomik, mbrojtja e mjedisit dhe dimensionit social mbështesin njëri-tjetrin. Ky vizion është realist dhe i orientuar drejt së ardhmes, duke theksuar se suksesi varet nga bashkëpunimi ndër-institucional, angazhimi i sektorit privat dhe përfshirja aktive e qytetarëve.

5.1 Objektivat strategjike

Tranzicioni i drejtë, në përputhje me dokumentet strategjike dhe legjislationin në fuqi, zbatohet përmes tri (3) objektive strategjike që së bashku përcaktojnë kornizën kombëtare për arritjen e një tranzicioni të drejtë e gjithëpërfshirës. Këto objektiva lidhin mbrojtjen e mjedisit me nevojat sociale dhe ekonomike, duke krijuar një bazë të qëndrueshme për një tranzicion të zbatueshëm për qytetarët. Objektivat e këtij udhërrëfyesi janë në linjë të drejtpërdrejtë me Strategjinë e Energjisë për periudhën 2022–2031.

Dekarbonizimi i sektorit të energjisë

Në përputhje me objektivat strategjike të dekarbonizimit, Kosova do të ndjekë një qasje të balancuar që ndërthur zhvillimin e kapaciteteve të reja nga burimet e ripërterishme të energjisë me ruajtjen e sigurisë së furnizimit dhe stabilitetit të sistemit gjatë periudhës së tranzicionit.

a) Objektiv specifik: Rritja e kapaciteteve të reja gjeneruese nga BRE

Rritja e kapaciteteve të reja gjeneruese nga burimet e ripërtëritshme është shtylla kryesore e dekarbonizimit. Synohet zhvillimi dhe integrimi i kapaciteteve të reja nga energjia diellore dhe e erës, të shoqëruara me sisteme të ruajtjes së energjisë dhe mekanizma fleksibiliteti, për të rritur pjesëmarrjen e energjisë së pastër dhe për të ulur gradualisht emetimet. Gjatë periudhës afatshkurtër parashihet operimi komercial i centralit fotovoltaiik prej 100 MW nga ankandi diellor, ndërtimi i rreth 100 MW nga ankandi i erës, si dhe zhvillimi i kapaciteteve të reja diellore prej 100 MW në zonat e KEK-ut. Gjatë periudhës afatmesme pritet zgjerimi i mëtejshëm i kapaciteteve nga era dhe dielli, drejt cakut kumulativ prej rreth 1600 MW nga BRE deri në vitin 2031.

Integrimi i kapaciteteve të ruajtjes së energjisë përmes baterive (BESS) është thelbësor për funksionimin efikas të një sistemi me pjesëmarrje të lartë të BRE-ve. Duke adresuar ndryshueshmërinë e prodhimit nga dielli e era, këto sisteme kontribuojnë në balancimin e prodhimit dhe konsumit, në reduktimin e ngarkesës së pikut dhe në përmirësimin e stabilitetit të rrjetit.

b) Objektiv specifik: Përmirësimi i performancës mjedisore dhe dalja graduale nga linjiti

Për të garantuar sigurinë e furnizimit gjatë fazës së tranzicionit energjetik, do të realizohen investime në rehabilitimin dhe modernizimin e kapaciteteve ekzistuese, dhe gazifikimin e thëngjillit bazuar në një studim paraprak fizibiliteti për shfrytëzim të kësaj teknologjie sipas standardeve të Bashkimit Europian. Gjatë kësaj periudhe, fokusi do të jetë në aplikimin e teknologjive më efikase, me emetime më të ulëta dhe me performancë më të mirë mjedisore, duke mundësuar shfrytëzimin më të qëndrueshëm të resurseve vendore dhe reduktimin progresiv të

ndikimit në mjedis. Kjo qasje do të krijojë hapësirë për integrimin e zgjidhjeve të reja teknologjike që mbështesin dekarbonizimin, fleksibilitetin e sistemit dhe sigurinë afatgjatë energjetike.

TC "Kosova B" (njësitë B1 dhe B2) do të rehabilitohet e modernizohet për të përmbushur standardet e detyrueshme të Direktivës për Emetimet Industriale: parashihet instalimi i elektrofiltrave, reduktimi i emitimeve të pluhurit (PM) nën nivelin 20 mg/Nm³, reduktimi i emitimeve të oksideve të azotit (NO_x) nën nivelin 200 mg/Nm³ dhe instalimi i pajisjeve për desulfurizimin e gazrave të tymit (FGD) për uljen e emitimeve të dioksidit të squfurit (SO₂) në nivelin 200 mg/Nm³. Modernizimi i turbinave zgjat jetëgjatësinë e dobishme të njësive për rreth njëzet (20) vjet, duke i mundësuar "Kosova B" të shërbejë si kapacitet bazë më i pastër gjatë gjithë fazës kalimtare.

Për TC "Kosova A", qasja është kombinimi i rehabilitimit dhe modernizimit për të ulur emetimet në dy njësi sipas Strategjisë së Energjisë dhe reduktimit gradual të përdorimit për të mbetur përfundimisht si rezervë strategjike për periudhat kur kërkesa është e lartë ose në rast krize. Reduktimi i mëtejshëm i përdorimit të njësive të mbetura të TC "Kosova A" deri në pikën kur mbeten si rezervë strategjike do të bëhet pasi të sigurohet kapaciteti zëvendësues bazë dhe rezerva e mjaftueshme nga burimet alternative, në mënyrë që siguria e furnizimit të mos rrezikohet në asnjë moment. Tabela e indikatorëve (Kapitulli 7) e lidh këtë sekuencë me caqe të matshme kohore.

Hapat konkretë, afatet dhe investimet për këtë sekuencë detajohen në Strategjinë Afatgjatë të Tranzicionit të Gjellbër dhe Dekarbonizimit të KEK-ut, e cila e operacionalizon në nivel korporate dekarbonizimin e parashtruar në këtë udhërrëfyes.

c) Objektiv specifik: Zhvillimi i sistemeve të ngrohjes qendrore dhe integrimi i burimeve të pastra

Sektori i ngrohjes qendrore luan rol të rëndësishëm në uljen e kërkesës për energji elektrike, veçanërisht gjatë sezonit dimëror. Burimet kryesore për ngrohje janë biomasa (kryesisht dru zjarri) dhe energjia elektrike, ndërsa qymyri, gazi i lëngëzuar i naftës (LPG) dhe nafta përdoren në masë më të kufizuar. Aktualisht, sistemet e ngrohjes qendrore mbulojnë rreth 289 MWth të kërkesës së përgjithshme për ngrohje. Është realizuar studimi i fizibilitetit për zhvillimin e sistemeve të reja të ngrohjes në disa komuna, ku janë identifikuar nevoja për kapacitete të konsiderueshme termike dhe potencial për zgjerim të rrjeteve ekzistuese.

Paralelisht janë ndërmarrë investime për përmirësimin e performancës së sistemeve ekzistuese. Termokos ka realizuar investime të rëndësishme në zgjerimin dhe rehabilitimin e rrjetit të ngrohjes, të cilat kanë kontribuar në rritjen e cilësisë së shërbimit për konsumatorët. Me qëllim të diversifikimit të burimeve, po zhvillohet projekti, i cili përfshin ndërtimin e një impianti termik diellor prej rreth 30 MW dhe integrimin e tij në sistemin ekzistues të ngrohjes qendrore të Prishtinës, së bashku me zgjerimin e rrjetit me kapacitet deri në 50 MWth; projekti pritet të lidhë deri në rreth 38.000 banorë të rinj me rrjetin e ngrohjes.

Në këtë drejtim, synohet zgjerimi dhe modernizimi i infrastrukturës së ngrohjes qendrore përmes shfrytëzimit të burimeve të pastra dhe teknologjive me emetime të ulëta. Fokusi do të jetë në zgjerimin e sistemeve ekzistuese dhe në zhvillimin e sistemeve të reja në komuna, të bazuara në BRE.

d) Objektiv specifik: Përmirësimi i efikasitetit të energjisë në ndërtesa

Rritja e efikasitetit të energjisë është hap kyç drejt një tranzicioni të drejtë energjetik, sikurse parashihet në Strategjinë e Energjisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2022–2031 dhe në këtë udhërrëfyes. Ajo kontribuon drejtpërdrejt në përmirësimin e sigurisë së furnizimit, uljen e kostove për konsumatorët dhe reduktimin e emetimeve të gazrave serrë e të ndotjes së ajrit. Zbatimi i masave të efikasitetit redukton konsumin në sektorin publik, privat dhe komercial.

Objektivi i përgjithshëm është kufizimi i konsumit final të energjisë në 1877 ktoe deri në vitin 2031, përmes rritjes së vazhdueshme të investimeve dhe projekteve në të gjithë sektorët e konsumit. Sektori i ndërtesave është prioritet kyç, pasi përbën mbi dyzet për qind (40%) të konsumit total të energjisë në vend. Rritja e efikasitetit do të arrihet përmes vendosjes dhe zbatimit të standardeve minimale të performancës energjetike, aplikimit të certifikatave të performancës energjetike për ndërtesat e reja dhe ato në rinovim, si dhe përmes skemave të dedikuara mbështetëse të menaxhuara nga Fondi i Kosovës për Efikasitet të Energjisë (FKEE).

Masat kryesore përfshijnë promovimin e ndërtesave me konsum energjie afër zeros, përdorimin e teknologjive me efikasitet të lartë (si pompat termike dhe sistemet diellore termike), si dhe zbatimin e sistemit të certifikimit të performancës energjetike të ndërtesave.

5.1.2 Tranzicioni i drejtë për punëtorët dhe komunitetet

Objektivi i dytë synon të mbështesë punëtorët, familjet dhe komunitetet e prekura nga tranzicioni energjetik, veçanërisht në komunat e Obiliqit dhe Fushë Kosovës, ku përqendrimi i aktiviteteve të KEK-ut ka krijuar varësi të lartë ekonomike dhe të punësimit. KEK punëson rreth katër mijë e shtatëqind (4 700) persona, pjesa më e madhe e të cilëve janë të lidhur drejtpërdrejt ose tërthorazi me zinxhirin e prodhimit nga linjiti. Çdo masë e tranzicionit duhet të nisë nga ky realitet konkret: dalja nga linjiti nuk mund të paraprijë krijimit të alternativave të qëndrueshme të punësimit.

Parimi udhëheqës është “punë së pari”: vendet e reja të punës dhe programet e rikualifikimit duhet të jenë funksionale para se kapacitetet me linjit të nxirren nga prodhimi. Për këtë qëllim, tranzicioni i drejtë për punëtorët mbështetet në një grup instrumentesh konkrete, të përmbledhura në Tabelën 3.

Instrumenti	Përshkrimi	Burimi i financimit
Rikualifikim dhe trajnim profesional	Programe të synuara për kalimin drejt sektorëve të BRE-ve, efikasitetit, ngrohjes qendrore dhe shërbimeve të gjelbra; me caqe të matshme pjesëmarrjeje dhe punësimi pas trajnimit.	Donatorë (GIZ, ILO, IPA)

Instrumenti	Përshkrimi	Burimi i financimit
Punësim i drejtpërdrejtë në projektet e reja	Përparësi për fuqinë punëtore vendore në projektet e BRE-ve dhe rehabilitimit	Investitorë privatë / KEK
Diversifikim ekonomik i rajonit të Obiliqit	Zbatim i udhërrëfyesit socio-ekonomik, përfshirë ripërdorimin e zonave të ish-minierave dhe deponive.	Donatorë / buxhet / investime private
Mbështetje për konsumatorët e cenueshëm	Masa kundër varfërisë energjetike.	Buxheti i shtetit

Tabela 3. Instrumentet e tranzicionit të drejtë për punëtorët dhe komunitetet

Procesi do të zhvillohet në koordinim të ngushtë me transformimin dhe dekarbonizimin e sektorit, përfshirë hartimin dhe zbatimin e Strategjisë Afatgjatë të Tranzicionit të Gjellbër dhe Dekarbonizimit të KEK-ut. Duke pasur parasysh rolin qendror të KEK-ut, transformimi gradual i kësaj ndërmarrjeje është element kyç për tranzicionin në nivel kombëtar. Strategjia e KEK-ut do të përcaktojë rrugëtimin gradual të transformimit, diversifikimin e aktiviteteve, zhvillimin e kapaciteteve të reja nga BRE, identifikimin e mundësive të reja të biznesit dhe transformimin gradual të kapaciteteve ekzistuese me bazë linjiti, në mënyrë që të ruhet siguria e furnizimit.

Një dimension i veçantë i tranzicionit të drejtë është barazia gjinore. Në përputhje me Strategjinë e Energjisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2022–2031, synohet që deri në vitin 2031 të paktën njëzet e pesë për qind (25%) e të punësuarve në sektorin e energjisë të jenë gra, përmes programeve të dedikuara të arsimimit, trajnimit dhe punësimit, me mbështetje nga partnerë si UN Women. Po ashtu, vëmendje e veçantë do t’u kushtohet të rinjve dhe grupeve të marginalizuara, për të siguruar që tranzicioni të mos riprodhojë pabarazi ekzistuese.

5.1.3 Korniza qeverisëse dhe institucionale

Zbatimi efektiv i tranzicionit të drejtë kërkon koordinim të fortë institucional, mekanizma të qartë të qeverisjes dhe bashkëpunim të vazhdueshëm ndërmjet institucioneve qendrore e lokale, sektorit privat, partnerëve zhvillimorë, sindikatave, shoqërisë civile dhe komuniteteve lokale.

Duke pasur parasysh natyrën ndërsektoriale të tranzicionit, kjo temë do të trajtohet në kuadër të mekanizmave institucionale për ndryshime klimatike dhe tranzicion të gjellbër të përcaktuar me Ligjin për Ndryshimet Klimatike. Koordinimi strategjik dhe institucional do të zhvillohet përmes Këshillit Kombëtar për Ndryshime Klimatike (KKNK), i cili shërben si organ koordinues për politikën klimatike në Republikën e Kosovës dhe do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij udhërrëfyesi.

Këshilli do të mundësojë koordinimin ndërmjet institucioneve përgjegjëse për energji, ekonomi, punësim, mjedis, financa, zhvillim rajonal dhe politika sociale, në mënyrë që tranzicioni të zhvillohet në mënyrë të koordinuar, të planifikuar dhe gjithëpërfshirëse. Institucionet përgjegjëse

do të sigurojnë përfshirjen aktive të komunave, sektorit privat, partnerëve ndërkombëtarë, sindikatave dhe organizatave të shoqërisë civile në planifikimin dhe zbatimin e tranzicionit, përmes konsultimeve të strukturuar e të dokumentuara.

6. Korniza financiare dhe prioritetet për investime

Tranzicioni i drejtë do të financohet përmes një kombinimi burimesh vendore dhe ndërkombëtare, buxhetit të shtetit, investimeve private, kredive dhe granteve nga institucionet financiare ndërkombëtare, të cilat do të menaxhohen në mënyrë të koordinuar dhe transparente. Strategjia e Energjisë për periudhën 2022–2031 parasheh investime të përgjithshme prej rreth 1 miliard euro për sektorin, të financuara nga buxheti i shtetit, investimet private dhe donacionet ndërkombëtare; korniza financiare e këtij udhërrëfyesi ndërtohet mbi këtë bazë dhe e plotëson atë me dimensionin social të tranzicionit.

Përmes këtij mekanizmi synohet që financimi të realizohet në mënyrë të strukturuar dhe në përputhje me prioritetet kombëtare. Burimet financiare do të orientohen drejt masave që adresojnë ndikimet sociale dhe ekonomike, me qëllim që tranzicioni të jetë gjithëpërfshirës dhe i planifikuar. Çdo investim do të vlerësohet sipas ndikimit social, ekonomik dhe mjedisor.

6.1 Parimet e financimit

Të gjitha burimet e financimit duhet të menaxhohen sipas rregullave të qarta për përdorimin, kontrollin dhe raportimin e fondeve, të mbështetura nga mekanizma monitorimi që mundësojnë ndjekjen e progresit. Përparësi do t'u jepet projekteve që kontribuojnë drejtpërdrejt në:

- zhvillimin e kapaciteteve të reja nga BRE dhe rritjen e fleksibilitetit të sistemit;
- krijimin e vendeve të reja të punës në nivel lokal dhe përmirësimin e kushteve mjedisore;
- projektet zhvillimore në zonat e ish-minierave apo deponive të KEK-ut;
- programet e trajnimit dhe rikualifikimit profesional për fuqinë punëtore të prekur;
- investimet në infrastrukturë komunale që përmirësojnë shërbimet publike dhe cilësinë e jetës.

6.2 Burimet dhe struktura indikative e financimit

Kosova do të vazhdojë të shfrytëzojë mbështetjen teknike dhe financiare nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe partnerët zhvillimorë. Korniza kryesore e granteve është Korniza Investuese për Ballkanin Perëndimor (WBIF), përmes së cilës Kosova ka përfituar rreth 298,9 milionë euro grante në periudhën 2008–2025, që kanë mbështetur investime të vlerësuara në rreth 2 miliardë euro. WBIF-i kombinon grante të BE-së me kredi nga BEI, BERZh dhe KfW, dhe është pjesë e Planit Ekonomik dhe të Investimeve të BE-së për Ballkanin Perëndimor (rreth 9 miliardë euro grante, me synim mobilizimin e deri 30 miliardë eurove investime).

Projekti Solar4Kosova ofron një model konkret të strukturimit grant–kredi: për një central diellor prej 100 MW me kosto rreth 104 milionë euro, financimi përbëhet nga një grant prej 32 milionë euro (WBIF/BE), një kredi prej 33 milionë euro (BEI) dhe një kredi prej 29 milionë euro (KfW). Ky raport kostoje afërsisht 1,0–1,1 milionë euro për MW të instaluar që shërben si pikë referimi për vlerësimin indikativ të kostonë së zhvillimit të kapaciteteve të reja diellore. Tabela 4 paraqet strukturën indikative të kostonë dhe financimit sipas fushave kryesore të investimit.

Fusha e investimit	Kosto indikative	Burimet kryesore të financimit
Kapacitete të reja nga BRE ($\approx$ 1.320 MW: erë, diell, biomasë, prosumatorë)	$\approx$ 1,0–1,5 mld € (vlerësim indikativ)	Investime private dhe publike, kredi IFN-së dhe grante WBIF-it.
Ruajtje e energjisë me bateri (BESS, $\approx$ 170 MW)	USD 236.7 million	U.S. Government MCC / Buxheti i shtetit
Rehabilitimi dhe modernizimi mjedisor i TC "Kosova B", njësisë (A3) dhe një njësie tjetër të TC "Kosova A" (FGD, elektrofiltra, NOx)	€ 275.4 million	KEK
Ngrohja Qendrore (NQ) në Prishtinë (50 MWth solare shitesë dhe zgjerimi i rrjetit). Sisteme të reja të Ngrohjes Qendrore (NQ) në së paku dy (2) qytete të reja. Dyfishimi i kapaciteteve të ngrohjes nga kogjenerimi në KEK	Pjesë e paketës WBIF	Grante WBIF / kredi KfW-BEI / donatorë
Eficienca e Energjisë (EE) deri 865,8 ktoe kursime	Vlerësim indikativ	Donatorë / IPA / FKEE / Buxhet i shtetit
Tranzicioni i drejtë për punëtorët dhe komunitetet	Vlerësim indikativ	Buxheti i shtetit/ donatorë

Tabela 4. Struktura indikative e koston dhe e financimit sipas fushave të investimit

Shënim metodologjik: vlerat e koston janë vlerësime indikative, të ankoruara në koston e Strategjisë së Energjisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2022–2031 dhe në koston reale të projekteve referencë.

Partnerët kryesorë përfshijnë Bankën Botërore (BB), Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh), BEI-n, KfW dhe GIZ, Komisionin Evropian (fondet IPA), agjencitë e Kombeve të Bashkuara (UNDP, UN Women, ILO), Agjencinë për Zhvillim të Luksemburgut, si dhe partnerë të tjerë zhvillimorë. Sektori privat pritet të luajë rol të rëndësishëm, veçanërisht në fushën e BRE-ve dhe teknologjive inovative, kryesisht përmes ankandave konkurruese.

7. Plani i zbatimit, korniza monitoruese dhe indikatorët kyç të performancës

Zbatimi i udhërrëfyesit kërkon një organizim të qartë të periudhave kohore, përgjegjësi dhe mekanizme të ndjekjes së progresit. Ky kapitull përcakton se si do të realizohen masat e parashikuara, si do të koordinohen institucionet dhe si do të sigurohet që rezultatet të jenë të matshme dhe të qëndrueshme në kohë. Qasja bazohet në një ndarje të qartë ndërmjet planifikimit strategjik dhe zbatimit praktik, duke siguruar që objektivat e përcaktuara në kapitujt paraprakë të përkthehen në veprime konkrete, të ndjekura përmes një sistemi të rregullt monitorimi dhe vlerësimi.

7.1 Fazat e zbatimit

Tranzicioni do të zbatohet në tri (3) faza të njëpasnjëshme, duke siguruar zbatim gradual dhe të qëndrueshëm. Faza e parë, afatshkurtër për periudhën 2026–2028, do të krijojë bazën ligjore dhe institucionale. Faza e dytë, afatmesme për periudhën 2029–2032, do të fokusohet në zbatimin e programeve dhe në shtrirjen e investimeve. Faza e tretë, afatgjatë 2033 e tutje, do të synojë forcimin e rezultateve dhe integrimin e plotë të tyre në politikat afatgjata. Secila fazë do të përcaktojë afate, përgjegjësi institucionale dhe rezultate të matshme. Procesi do të rishikohet sipas nevojës, në mënyrë që masat të përshtaten me sfidat e reja, prioritetet e vendit, angazhimet ndërkombëtare dhe zhvillimet në treg.

7.1.1 Faza afatshkurtër për periudhën 2026–2028

Në këtë fazë vendosen themelet për zbatimin e tranzicionit të drejtë. Fokusi kryesor është krijimi i një kornize funksionale që mundëson koordinim institucional, financim të qëndrueshëm dhe fillimin e aktiviteteve konkrete në terren.

Fusha	Veprimet kryesore
Qeverisja	Zgjerimi i mandatit të Këshillit Kombëtar për Ndryshime Klimatike me përgjegjësi të reja në raport me Tranzicionin e Drejtë; hartimi i Strategjisë Afatgjatë të Tranzicionit të Gjellbër dhe Dekarbonizimit të KEK-ut; integrimi me NECP për periudhën 2025–2030.
Zhvillimi i kapaciteteve të reja	Përgatitja dhe zbatimi i projekteve për BRE, BESS, Ngrohje Qendrore (NQ) dhe renovim të ndërtesave.
Mbrojtja sociale	Dokumentimi i fuqisë punëtore të prekur dhe ndikimi i tranzicionit tek ta; krijimi i regjistrat të konsumatorëve të cenueshëm dhe mbështetja e tyre me masa mbështetëse sipas legjislacionit në fuqi.

Tabela 5. Veprimet kryesore në fazën afatshkurtër

Në përfundim të kësaj faze, pritet që Kosova të ketë një strukturë funksionale të menaxhimit të tranzicionit, një kornizë të qartë ligjore e financiare, si dhe projektet e para të gatshme për zbatim.

7.1.2 Faza afatmesme për periudhën 2029 – 2032

Kjo fazë është periudha kryesore e zbatimit, ku fokusi zhvendoset nga përgatitja në realizimin konkret të investimeve dhe masave. Gjatë kësaj periudhe do të zhvillohen kapacitetet e reja të BRE-ve, do të zbatohen projektet e ruajtjes së energjisë dhe do të zgjerohet infrastruktura e Ngrohjes Qendrore (NQ). Një element i rëndësishëm është adresimi i ndikimeve sociale përmes masave për punësim, rikualifikim dhe zhvillim ekonomik lokal, veçanërisht në zonat e prekura.

Projektet	Veprimet kryesore
BRE	Ndërtimi i kapaciteteve të reja nga Burimet e Ripërtëritshme (BR).
Ruajtja e energjisë	Zbatimi i projekteve të BESS.
Renovimi i ndërtesave	Zbatimi i projekteve të renovimit të ndërtesave publike dhe renovimi i ndërtesave në sektorin rezidencial.
Sistemet e Ngrohjes Qendrore (NQ)	Zbatimi i projekteve të Ngrohjes Qendrore (NQ).
Masa sociale dhe punësimi	Dokumentimi i fuqisë punëtore të prekur dhe përgatitja e programeve për trajnim e rikualifikim, me qëllim ruajtjen dhe krijimin e mundësive të reja të punësimit.

Tabela 6. Veprimet kryesore në fazën afatmesme

Në përfundim të kësaj faze, pritet rritje e ndjeshme e kapaciteteve energjetike, zhvillim ekonomik lokal dhe përmirësim i dukshëm i kushteve mjedisore.

7.1.3 Faza afatgjatë 2033 e tutje

Faza afatgjatë fokusohet në konsolidimin e rezultateve dhe në funksionimin e qëndrueshëm të sistemit energjetik. Sistemi do të karakterizohet nga pjesëmarrje e lartë e BRE-ve, kapacitete të modernizuara dhe mekanizma të avancuar të operimit dhe menaxhimit.

Kapacitetet e TC “Kosova B” do të vazhdojnë të operojnë si kapacitete bazë të sistemit, të modernizuara dhe të përshtatura me standardet mjedisore në fuqi, duke garantuar stabilitet dhe siguri të furnizimit. Ndërkohë, kapacitetet e TC “Kosova A” do të ndalen gradualisht nga prodhimi aktiv pas sigurimit të kapaciteteve zëvendësuese dhe do të transformohen në rezerva strategjike, të aktivizuara vetëm në periudhat me kërkesë të lartë, për nevoja ngrohjeje përmes kogjenerimit dhe në raste krizash energjetike, në linjë me angazhimin për heqjen graduale të qymyrit deri në vitin 2050.

Paralelisht, do të vazhdojë zhvillimi i kapaciteteve të reja nga BRE, integrimi i BESS, zgjerimi i ngrohjes qendrore dhe investimet në eficiencë. Bazuar në ndërhyrjet e planifikuara, pritet të arrihen rezultatet në vijim:

- reduktimi gradual i prodhimit në njësitë e TC “Kosova A” për të mbetur si rezervë strategjike;

- zhvillimi i mëtejshëm i projekteve të BRE-ve dhe i sistemeve të ruajtjes së energjisë;
- zgjerimi i ngrohjes qendrore në komunat e mbetura, për të reduktuar kërkesën për energji elektrike gjatë dimrit;
- përfshirja sociale dhe barazia, me synim uljen e varfërisë dhe papunësisë në komunat e prekura;
- integrimi i barazisë gjinore dhe përfshirja e grupeve të marginalizuara e të rinjve në tregun e punës;
- zhvillimi i një fuqie punëtore të kualifikuar përmes reformave në arsim profesional, trajnim dhe rikualifikim;
- zbatimi i instrumenteve financiare gjithëpërfshirëse për biznese, punëtorë dhe komunitete të prekura;
- përmirësimi i ndjeshëm i gjendjes mjedisore përmes rehabilitimit të zonave të ish-minierave dhe deponive.

7.2 Indikatorët e performancës

Për të vlerësuar progresin e zbatimit do të përdoret një grup i kufizuar indikatorësh strategjikë që pasqyrojnë rezultatet kryesore të tranzicionit të drejtë. Këta indikatorë do të monitorohen në baza vjetore dhe lidhen drejtpërdrejt me objektivat strategjike të Kapitullit 5 dhe masat e zbatimit të këtij kapitulli. Vlerat fillestare i referohen vitit 2026 ose të dhënave më të fundit të disponueshme.

Indikatori	Njësia	Pika fillestare (2026)	Caku (2032)
Kapacitetet nga BRE	MW	370	1.200
Ruajtja e energjisë me bateri	MW	0	170
Pjesëmarrja e BRE-ve në prodhimin e energjisë elektrike	%	8	35
Gratë në fuqinë punëtore të sektorit të energjisë	%	< 20	25 (deri 2031)
Zgjerimi i Ngrhjes Qendrore (NQ) në Prishtinë	MWth	–	50 solar 140 nga kogjenerimi
Ngrhje Qendrore (NQ) nga BRE	–	Studim i fizibilitetit i përfunduar	Zbatimi i projekteve në dy komuna
Reduktimi i emetimeve	Mt CO ₂	≈ 7	≤ 5

Indikatori	Njësia	Pika fillestare (2026)	Caku (2032)
Kursime kumulative të energjisë (ndërtesa publike, rezidenciale, komerciale)	ktoe	26,64	279,72

Tabela 7. Indikatorët kyç të performancës (KPI), me pikë fillestare dhe cague

7.3 Menaxhimi i rrezikut

Rreziqet kryesore janë vlerësuar sipas gjasave dhe ndikimit dhe i janë caktuar një institucioni përgjegjës (pronar i rrezikut), për të mundësuar prioritizimin dhe ndjekjen e tyre.

Rreziku	Gjasat	Ndikimi	Bartës i rrezikut	Masat zbutëse
Ndarje të pamjaftueshme buxhetore ose vonesë në financim nga donatorët.	I lartë	I lartë	MFPT/ME	Planifikim i hershëm i nevojave, mobilizim i fondeve nga partnerët dhe mekanizma rezervë për projektet prioritare.
Rrezikimi i sigurisë së furnizimit gjatë daljes nga linjiti.	Mesatar	I lartë	ME / KEK / KOSTT	Sekuenca “punët dhe kapaciteti zëvendësues së pari”; mbajtja e njësive si rezervë strategjike derisa BRE+BESS të jenë të mjaftueshme.
Koordinim i pamjaftueshëm dhe paqartësi në përgjegjësi	Mesatar	Mesatar	Këshilli Kombëtar për Ndryshime Klimatike (KKNK)	Forcimi i mekanizmave koordinues, përcaktimi i roleve dhe procedura standarde për zbatim e monitorim.
Mungesë përfshirjeje dhe mbështetjeje e komuniteteve e punëtorëve.	Mesatar	I lartë	ME / MF / MPFVLÇ	Konsultime të hershme me palët e prekura, skema kompensimi dhe komunikim i hapur e transparent.
Vonesa në realizimin e projekteve të BRE-ve	Mesatar	Mesatar	ME / KOSTT	Thjeshtëzim i procedurave të lejeve, planifikim e monitorim i rregullt dhe përcaktim i qartë i përgjegjësi.
Rehabilitim i pamjaftueshëm i zonave	I ulët–Mesatar	Mesatar	MMPH / KEK	Auditime për përputhshmëri mjedisore

Rreziku	Gjasat	Ndikimi	Bartës i rrezikut	Masat zbutëse
të prekura nga aktivitetet minerare				dhe verifikim i pavarur për projektet përkatëse.

Tabela 8. Regjistri i rreziqeve, me probabilitet, ndikim, pronar dhe masa zbutëse

7.4 Masat kryesore të zbatimit

Për të siguruar që objektivat strategjike të përkthehen në veprime të zbatueshme, tabela në vijim përmbledh masat kryesore të tranzicionit të drejtë, duke përcaktuar institucionet përgjegjëse, afatet kohore, burimet e financimit dhe caqet.

Masa	Institucioni përgjegjës	Afati kohor	Burimi i financimit	Caqet
Zhvillimi i kapaciteteve të reja nga BRE	Ministria e Ekonomisë (ME)	2026 e tutje	Investime private / IFN / grante WBIF	2.650 MW të instaluar
Instalimi i kapaciteteve për ruajtje të energjisë (BESS)	Ministria e Ekonomisë (ME)	2026–2029	Investime private / IFN / buxhet	170 MW
Rehabilitimi dhe modernizimi mjedisor i TC “Kosova B”, dhe njërive të TC “Kosova A” në përputhje me Strategjinë e Energjisë	KEK	2026–2029	KEK	Përmbushje e standardeve IED; NO _x dhe SO ₂ në 200 mg/Nm ³
Reduktimi gradual i prodhimit në njësitë e TC “Kosova A”.	ME / KEK / KOSTT	2031 e tutje	Buxhet / KEK	Kalim në rezervë strategjike
Zgjerimi dhe modernizimi i Ngrohjes Qendrore (NQ)	Komunat / Ministria e Ekonomisë (ME)	2026 e tutje	Grante WBIF / KfW–BEI / donatorë	4–9 komuna
Përmirësimi i efikasitetit të energjisë (ndërtesa, sektor publik e privat)	Ministria e Ekonomisë (ME)/ FKEE	2026 e tutje	Donatorë / IPA / FKEE	865,8 ktoe të kursyera
Tranzicioni i drejtë për punëtorët (rikualifikim, skema dalëse, diversifikim)	ME / MF / MPFVLÇ / KEK	2026 e tutje	Donatorë	Punësim para reduktimit të kapaciteteve; njëzet e pesë

Masa	Institucioni përgjegjës	Afati kohor	Burimi i financimit	Caqet
				për qind (25%) gra në sektor
Monitorimi dhe raportimi i progresit	Këshilli Kombëtar për Ndryshime Klimatike (KKNK)	2026 e tutje	Buxheti i shtetit	Raporte vjetore progres ndaj objektivave

Tabela 9. Masat kryesore të tranzicionit të drejtë

7.5 Përmirësimi i vazhdueshëm i politikave dhe i zbatimit

Zbatimi i këtij udhërrëfyesi do të jetë një proces dinamik. Bazuar në rezultatet e monitorimit dhe në ndryshimet në treg, institucionet do të kenë mundësi të rishikojnë dhe përmirësojnë masat, në mënyrë që tranzicioni të mbetet i qëndrueshëm dhe i përshtatur me nevojat reale të vendit. Çdo rishikim do të reflektohet në raportimin periodik ndaj NECP-së dhe Komunitetit të Energjisë.

Përmirësimi i vazhdueshëm i politikave mbështetet edhe nga dokumente plotësuese në nivel sektorial e korporativ. Në veçanti, Strategjia Afatgjate e Tranzicionit të Gjellbër dhe Dekarbonizimit të KEK-ut e plotëson këtë udhërrëfyes, duke përcaktuar masat konkrete, afatet dhe investimet për transformimin e kapaciteteve gjeneruese të KEK-ut. Ndërsa udhërrëfyesi përcakton kornizën kombëtare të tranzicionit të drejtë, strategjia e KEK-ut e operacionalizon atë në nivel korporate. Të dy dokumentet do të rishikohen në mënyrë të koordinuar, duke siguruar koherencë midis objektivave kombëtare dhe planifikimit operativ.

Referencat

Burimet e mëposhtme përbëjnë bazën ligjore, strategjike dhe të të dhënave të këtij udhërrëfyesi.

- [1] Ministria e Ekonomisë (ME), *Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës për periudhën 2022–2031* (miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 8 mars 2023). Prishtinë. <https://me.rks-gov.net/en/energy-2/>
- [2] *Deklarata e Sofjes për Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor* (Sofia Declaration on the Green Agenda for the Western Balkans). Samiti i Sofjes, 2020.
- [3] *Plani Kombëtar për Energji dhe Klimë (NECP) për periudhën 2025–2030*, dhe komentet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (SKE).
- [4] *Traktati i Komunitetit të Energjisë (TKE) dhe vendimet përkatëse të Këshillit Ministror (KM) për objektivat e BRE-ve dhe reduktimin e Gazrave Serrë (GS); Plani Kombëtar për Reduktimin e Emetimeve (NERP)*.
- [5] Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) ShA, *Profili i KEK-ut*. <http://kek-energy.com/kek/profili-i-kek-ut/>
- [6] Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRë), *Vendime për ankandet e kapaciteteve diellore dhe tarifut* (ankandi i parë diellor, 2024; Kramovik, Rahovec; 48,88 €/MWh).
- [7] Western Balkans Investment Framework (WBIF) dhe Banka Evropiane e Investimeve (BEI), *Solar4Kosovo – Photovoltaic Plant* (kosto rreth 104 mln €; grant WBIF 32 mln €, kredi BEI 33 mln €, kredi KfW 29 mln €). <https://www.wbif.eu/beneficiaries/kosovo>
- [8] GIZ, *Analizë socio-ekonomike dhe udhërrëfyes i tranzicionit të drejtë për rajonin e Obiliqit (Kastriot)*.
- [9] Komuniteti i Energjisë / Korniza e financimit (IPF 10), *Kosovo, District Heating Systems: Feasibility Study, ESIA*; studim fizibiliteti për sistemet e Ngrohjes Qendrore (NQ) në Kosovë.
- [10] German Economic Team (GET), *Modelime për arritjen e cakut të BRE-ve mbi tridhjetë e pesë për qind (35%) në konsumin final të energjisë; Kosovo's new energy policy agenda*.

Shënim: shifrat kryesore në tabela referojnë vitin dhe burimin përkatës; vlerësimet e kostos në Tabelën 4 janë indikative dhe do të konfirmohen në plane veprimi të kostuara.